



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
REKTORI

Nr. 857 Prot.

Tiranë më 14.04 2022

URDHËR

Nr. 33, datë 14/04/2022

“PËR

HAPJEN E PRANIMEVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË ‘TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT’, ME NËNFUSHA ‘INXHINIERI INFORMATIKE’ DHE ‘TELEKOMUNIKACION DHE INXHINIERI INFORMACIONI’, NË FAKULTETIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT”

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 dhe Udhëzimin Nr. 7, datë 31.3.2021, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë”, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës, Neni 5, si dhe në zbatim të Urdhrit të MAS, Nr. 175, datë 4.4.2022, “Për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në ‘Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, me nënfusha ‘Inxhinieri Informatike’ dhe ‘Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni’”,

URDHËROJ:

Hapjen e pranimeve në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë “Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, me nënfusha ‘Inxhinieri Informatike’ dhe ‘Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni’”, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit.

Aplikimet e kandidatëve për studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin Politeknik të Tiranës, do të kryhen nga data 15.04.2022 deri më datë 29.04.2022.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



REKTORI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upi.edu.al